



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 5 dhjetor 2019
Nr. ref.: RK 1474/19

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI126/19

Parashtrues

Lon Paluca

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 67/2019, të 20 marsit 2019

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Lon Paluca, fshati Trepeticë, komuna e Prizrenit (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), i cili përfaqësohet nga avokatët Gafurr Elshani dhe Sahit Bibaj, nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, [Rev. nr. 67/2019] (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme) të 20 marsit 2019.
3. Parashtruesi i kërkesës, vendimin e kontestuar e ka pranuar më 5 prill 2019.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes së kërkesës është shqyrtimi i kushtetutshmërisë së aktvendimit të kontestuar, me të cilin pretendohet të jenë shkelur të drejtat e parashtruesit të kërkesës, të garantuara me nenet 3 dhe 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), në lidhje me nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ) si dhe nenin 10 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: Deklarata Universale).
5. Në të njëjtën kohë, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata), të caktojë masën e përkohshme me të cilën do të vendoste *“NDALIMIN E EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE të Gjykatës së Apelit të Kosovës, CN. nr. 659/15 të datës 21.12.2018 si dhe vendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 67/2019 të datës 20 mars 2019 deri në vendimin përfundimtar të Gjykatës Kushtetuese”*.

Baza juridike

6. Kërkesa bazohet në paragrafin 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

7. Më 30 korrik 2019, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatë.
8. Më 31 korrik 2019, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Radomir Laban gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Arta Rama-Hajrizi (kryesuese), Selvete Gërzhaliu-Krasniqi dhe Bajram Ljatifi.
9. Më 20 gusht 2019, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.
10. Më 13 nëntor 2019, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Parashtruesi i kërkesës parashtroi për herë të dytë kërkesë në Gjykatë në lidhje me rastin e tij, duke kontestuar vendime të ndryshme të gjykatave të rregullta.
12. Gjykata në vijim do ta paraqes gjendjen faktike të zhvilluar në secilin nga dy rastet, edhe atë në lidhje me kërkesën KI116/10, dhe në lidhje me kërkesën KI126/19 e cila është si vijon:

Përmbledhja e fakteve në lidhje me kërkesën KI116/10

13. Më 14 janar 1975, parashtruesi i kërkesës kishte blerë një pronë të paluajtshme në komunën e Klinës, dhe kontratën e shitblerjes e kishte vërtetuar në gjykatë.
14. Më 18 janar 1977, Kuvendi Komunal i Klinës, Drejtorati për Ekonomi, Çështje Komunale dhe Çështje Ligjore Pronësore përmes Vendimit [Nr. 04-465/15/2] shpronësoi parashtruesin nga e drejta pronësore, Vendim ky me të cilin parashtruesi u pajtua, duke kërkuar si kompensim një pronë të ngjashme. Parashtruesi filloi procedurat gjyqësore për kompensim por nuk pati një vendim përfundimtar gjyqësor.
15. Pas vitit 1999, parashtruesi i kërkesës tentoi ta sigurojë dosjen e rastit dhe të vazhdojë procedurat gjyqësore, por Gjykata Komunale e Klinës e njoftoi parashtruesin se shkresat e lëndës së tij, nuk gjendeshin në gjykatë.
16. Parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesë për kompensim në Gjykatën Komunale të Klinës.
17. Më 16 tetor 2003, Gjykata Komunale e Klinës përmes Aktvendimit [C. nr. 54/2001] e aprovoi kërkesën, duke e obliguar Komunën e Klinës, në lidhje me pronën e shpronësuar t'i lejojë parashtruesit të kërkesës përdorimin e përhershëm të një lokali me përmasa të njëjta, sikurse prona që ishte shpronësuar. Komuna e Klinës paraqiti ankesë në Gjykatën e Qarkut kundër aktvendimit të lartpërmendur.
18. Më 8 maj 2007, Gjykata e Qarkut në Pejë, përmes Aktgjykimit [Ac. nr. 233/04] anuloi aktvendimin e lartpërmendur, duke konstatuar se parashtruesi i kërkesës nuk ka paraqitur ankesë për kompensim deri në vitin 2001, prandaj ankesa e parashtruesit të kërkesës ishte parashkruar. Parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme.
19. Më 6 maj 2010, Gjykata Supreme përmes Aktvendimit [Rev. nr. 286/2007] refuzoi si të pabazë ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi Vendimin e Gjykatës së Qarkut.
20. Më 23 maj 2011, Gjykata Kushtetuese nxori Aktvendimin për papranueshmëri në rastin KI116/10, duke shpallur kërkesën e parashtruesit të kërkesës si qartazi të pabazuar.

Përmbledhja e fakteve në lidhje me kërkesën KI126/19, që ndërlidhen me propozimin për përsëritje të procedurës

21. Më 31 maj 2013, parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesë në Gjykatën Themelore në Pejë-dega në Klinë (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore) për përsëritjen e procedurës kontestimore, duke pretenduar, mes tjerash, se është vënë në dijeni se ekzistojnë fakte të reja në bazë të së cilave do të mund të rezultonin me një vendim të favorshëm për parashtruesin e kërkesës. Parashtruesi i kërkesës pretendon se këto fakte nuk ka mundur t'i siguroj më herët (deklaratën ish- gjyqtarit Z. R. të Gjykatës Komunale në Klinë, të dhënë nën betim, të cilit i kujtohet se lënda e parashtruesit të kërkesës për kompensim ishte dorëzuar në Gjykatë para vitit 1999, dhe për të cilën nuk ka pasur vendim meritore). Parashtruesi i kërkesës pretendon se si rezultat i këtij fakti, pushojnë së ecuri afatet e parashkrimit.
22. Më 11 shtator 2014, Gjykata Themelore, përmes Aktvendimit [C. nr. 54/2001], lejoi përsëritjen e procedurës së përfunduar me aktgjykimin e plotfuqishëm të Gjykatës Komunale [C. nr. 54/2001] të 16 tetorit 2003, dhe të njëjtin e anulon. Gjykata Themelore arsyetimin e saj e bazon në faktin se parashtruesi i kërkesës nuk ka mundur më herët t'i parashtrojë këto prova të cilat i konsideron relevante për rastin e tij dhe në bazë të nenit 421, pika 9 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, Gjykata Themelore e lejon përsëritjen e procedurës.
23. Në një datë të paspecifikuar, Komuna e Klinës paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit, kundër Aktvendimit [C. nr. 54/2001] të Gjykatës Themelore, duke pretenduar shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale.
24. Më 21 dhjetor 2018, Gjykata e Apelit e Kosovës, përmes Aktvendimit [CN. nr. 659/2015] hedhë poshtë si të paafatshëm propozimin e parashtruesit të kërkesës për përsëritjen e procedurës dhe në këtë mënyrë e ndryshon Aktvendimin [C. nr. 54/2001] e Gjykatës Themelore, të 11 shtatorit 2014. Më tutje, në arsyetim theksohet:

“Në rastin e propozimit për lejimin e përsëritjes së procedurës nga ana e paditësit është ushtruar pas kalimit të afatit objektiv prej 5 vitesh i paraparë me dispozitën ligjore të nenit 234.3, me çka nën rrethanën e tillë Gjykata e Apelit aktvendimin e ankimuar e ka ndryshuar [...] pa marrë parasysh se në rastin konkret paditësi propozimin për përsëritje të procedurës del ta ketë ushtruar brenda afatit subjektiv prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita kur i njëjti ka marrë në dijeni për prova të reja dhe të njëjtat i ka parashtruar në gjykatë, sipas përcaktimit ligjor të paraparë me nenin 234.1 pika g) të LPK-së, në rastin konkret Gjykata e Apelit vlerëson se nuk mund të zbatohet afati subjektiv për paraqitjen e propozimit për përsëritjen e procedurës, pasi që afati subjektiv do të mund të vlerësohej vetëm në rast se propozimi për përsëritjen e procedurës nga ana e paditësit do të ishte paraqitur brenda afatit kohor objektiv prej 5 vitesh, duke llogaritur nga dita kur Aktgjykimi i Gjykatës Komunale C.nr.54/2001 i datës 16. 10.2003 kishte marrë formën e prerë”.

25. Më 29 janar 2019, parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur revizion në Gjykatën Supreme kundër Aktvendimit [CN. nr. 659/2015] të Gjykatës së Apelit, të 21 dhjetorit 2018, duke pretenduar zbatim të gabuar të së drejtës materiale.
26. Më 20 mars 2019, Gjykata Supreme e Kosovës, përmes Aktvendimit [Rev 67/2019], refuzoi si të pabazuar revizionin, duke e mbështetur plotësisht qëndrimin juridik të Gjykatës së Apelit.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

27. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me vendimin e kontestuar, Gjykata Supreme ka bërë shkelje të së drejtës së tij të mbrojtur me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe në lidhje me nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] të KEDNJ-së dhe shkeljen e të drejtave e arsyeton: *“Palët në procedurë nuk janë trajtuar barabarësisht, dhe se gjykatat nuk kanë shqyrtuar provat dhe faktet që ka ofruar ankuesi, dhe aq më tepër siç është cituar në mjetet juridike të parashtruara nga ankuesi me rastin e parashtrimit të propozimit në Gjykatë, që është provuar me procesverbal të të paditurës, por edhe me parashtrësë se pasi palët nuk kanë arrit pajtim për kompensim në procedurë administrative, lënda është dërguar në gjykatë, nga kjo bazë afatet e parashkrimit me rastin e dorëzimit të lëndës në Gjykatë pushojnë (neni 388 ish-LMD-së që ishte në fuqi)”*.
28. Tutje, parashtruesi i kërkesës pohon se *“procedurat në Gjykata nuk kanë qenë të drejta në tërësinë e tyre, duke i përfshirë edhe dëshmitë”*. Parashtruesi në kërkesën e tij i referohet rastit të Gjykatës KI49/11, parashtrues Ibrahim Sokoli, Aktvendim për papranueshmëri, i 5 dhjetorit 2012 dhe rastit të GJEDNJ-së, Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar, Aktgjykim i 10 korrikut 2009 .
29. Gjithashtu, parashtruesi i kërkesës pretendon se me vendimin e kontestuar Gjykata Supreme i ka shkelur të drejtat e tij të cilat janë të garantuara me nenet 3 dhe 24 [Barazia para Ligjit], dhe 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës si dhe nenin 10 të Deklaratës Universale, por të njëjtat në asnjë mënyrë nuk i arsyeton.
30. Lidhur me kërkesën për masë të përkohshme parashtruesi kërkon nga Gjykata që të ndalë ekzekutimin e vendimeve të Gjykatës së Apelit dhe të Gjykatës Supreme, deri në vendosje nga Gjykata.
31. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon që të anulohen vendimet e lartpërmendura dhe çështja të kthehet në rigjykim në Gjykatën Themelore.

Dispozitat Relevante Ligjore

LIGJI Nr. 03/L-006 PËR PROCEDURËN KONTESTIMORE

PËRSËRITJA E PROCEDURËS

Neni 232

Procedura e përfunduar me aktgjykim dhe aktvendim të formës së prerë të gjykatës mund të përsëritet sipas propozimit të palës:

a) në qoftë se palës me veprim të kundërligjshëm, e sidomos në rast të mosthirrjes për në seancë nuk i jepet mundësia që të marrë pjesë në shqyrtimin e çështjes kryesore;

b) në qoftë se në procedurën e përfunduar ka marrë pjesë si paditës ose si i paditur personi që nuk mund të jetë palë ndërgjyqëse, apo në qoftë se palën që është person juridik nuk e ka përfaqësuar personi i autorizuar, ose po që se palën me pazotësi procedurale nuk e ka përfaqësuar përfaqësuesi ligjor i saj, ose në qoftë se përfaqësuesi ligjor, respektivisht përfaqësuesi me prokurë i palës, nuk ka pasur autorizim të duhur për ndjekjen e çështjes në gjyq apo për kryerjen e veprimeve procedurale të caktuara, po që se ndjekja e çështjes në gjyq apo kryerja e veprimeve procedurale të caktuara nuk është lejuar më vonë nga pala;

[...]

g) në qoftë se pala merr dijeni për fakte të reja ose gjen prova të reja, ose e fiton mundësinë që t'i përdorë ato, në bazë të të cilave për palën do të mund të merrej vendim përfundimtar më i favorshëm, sikur faktet dhe provat e tilla të ishin përdorur në procedurën e mëparshme.

Neni 234

234.1 Propozimi për përsëritjen e procedurës paraqitet brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, dhe atë:

a) në rastin nga neni 232, pika a) e këtij ligji, që nga dita kur palës i është dorëzuar vendimi i formës së prerë;

b) në rastin nga neni 232, pika b) e këtij ligji në qoftë se në procedurë si paditës apo si i paditur ka vepruar personi që nuk mund të jetë palë ndërgjyqëse nga dita në të cilën vendimi i është dorëzuar personit të tillë;

[...]

234.3 Pas kalimit të afatit prej pesë vjetësh nga dita kur vendimi bëhet i formës së prerë, propozimi për përsëritjen e procedurës nuk mund të

paraqitet, përveçse kur përsëritja kërkohet nga shkaqet e përmendura në nenin 232, pika a) dhe b) të këtij ligji.

Pranueshmëria e kërkesës

32. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
33. Gjykata rikujton se parashtuesi ka parashtuar dy kërkesa në Gjykatën Kushtetuese. Kërkesa e parë, që kishte të bënte me procedurën kontestimore të parashtuesit të kërkesës ishte deklaruar nga Gjykata si qartazi e pabazuar përmes Aktvendimit për papranueshmëri në rastin KI116/10.
34. Në kërkesën e tanishme KI126/19, parashtuesi i kërkesës konteston para Gjykatës vendimet e gjykatave të rregullta që ndërlidhet me propozimin e tij për përsëritjen e procedurës që kanë përfunduar me Aktvendimin [Rev 67/2019] e Gjykatës Supreme, të 20 marsit 2019. Rrjedhimisht, Gjykata do të kufizohet vetëm në vlerësimin e vendimeve të gjykatave të rregullta që ndërlidhen me përsëritjen e procedurës, pasi që kjo është objekt i çështjes së kërkesës KI126/19.
35. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

36. Gjykata në vijim shqyrton nëse parashtuesi i kërkesës i ka plotësuar kushtet e pranueshmërisë siç janë përcaktuar me ligj. Në këtë kuptim, Gjykata i referohet neneve 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47 [Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ i mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49
[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”.

37. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kërkesave, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar i cili konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktvendimin [Rev. nr. 67/2019] e 20 marsit 2019, të Gjykatës Supreme, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me Ligj. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu i ka sqaruar të drejtat dhe liritë që pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe e kanë dorëzuar kërkesën në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.
38. Përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesit e kërkesës kanë përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet paragrafit 3 (b) të rregullit 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës, që parasheh:
- “(3) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të papranueshme nëse ndonjë nga kushtet në vijim është i pranishëm:
[...]
(b) kërkesa nuk është ratione materiae në pajtim me Kushtetutën;
[...].”*
39. Gjykata gjithashtu përsërit se në pajtim me nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës *“Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”.*
40. Sa i përket pretendimit të parashtruesit të kërkesës për shkelje të të drejtës së tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, Gjykata, duke iu referuar praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së dhe praktikës gjyqësore të saj, përsërit se neni 31 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së nuk zbatohen në kërkesat për të rihapur apo përsëritur procedurën (Shih, në mënyrë analoge, rastet e Gjykatës Kushtetuese: KI80/15, KI81/15 dhe KI82/15, parashtrues *Rrahim Hoxha*, Aktvendim për papranueshmëri, i 6 dhjetorit 2016, paragrafi 31; shih gjithashtu rastet e GJEDNJ-se, *inter alia*, *Oberschlick kundër Austrisë*, nr. 23727/94, Aktvendim për papranueshmëri, i 21 marsit 1994, *Dowsett kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 8559/08, Aktvendim për papranueshmëri, i 4 janarit 2011, *Sablon kundër Belgjikës*, nr. 36445/97, Aktgjykim i 10 prillit 2001, paragrafi 86).

41. Prandaj, Gjykata konsideron se neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] i Kushtetutës, në lidhje me nenin 6, paragrafin 1 të KEDNJ-së, nuk zbatohet në propozimin e parashtruesit për përsëritje të procedurës (Shih rastin e Gjykatës Kushtetuese: KI80/15, 81/15 dhe 82/15, *Rrahim Hoxha*, Aktvendim për papranueshmëri, i 27 dhjetorit 2016, paragrafi 32).
42. Gjykata thekson se pajtueshmëria *ratione materiae* e kërkesës me Kushtetutën rrjedh nga juridiksioni material i Gjykatës. E drejta në të cilën thirret parashtruesi i kërkesës duhet të mbrohet me Kushtetutë, në mënyrë që një ankesë kushtetuese të jetë në pajtim *ratione materiae* me Kushtetutën. Megjithatë, Kushtetuta nuk i garanton parashtruesit të kërkesës të drejtën për rishikim dhe përsëritje të procedurës (Shih, në mënyrë analoge, rastet e Gjykatës Kushtetuese: KI80/15, 81/15 dhe 82/15, *Rrahim Hoxha*, Aktvendim për papranueshmëri, i 27 dhjetorit 2016, paragrafi 33, KI07/17/15, *Pashk Mirashi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 12 qershorit 2017, paragrafi 66; KI 40/19, *Alije Shabani*, *Lulëzim Shabani*, *Luljeta Shabani dhe Kujtim Shabani*, Aktvendim për papranueshmëri, i 11 shtatorit 2019, paragrafi 41).
43. Rrjedhimisht, Gjykata konsideron se kërkesa e parashtruesit të kërkesës lidhur me refuzimin nga gjykatat e rregullta për të përsëritur procedurën nuk është *ratione materiae* në pajtim me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.
44. Sa i përket pretendimit të parashtruesit të kërkesës se me vendimin e kontestuar Gjykata Supreme i ka shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenet 3 dhe 24 [Barazia para Ligjit], dhe 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës si dhe nenin 10 të Deklaratës Universale, Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës këto shkelje nuk i ka arsyetuar në asnjë mënyrë por nenet në fjalë vetëm se i ka cekur në mënyrë taksative.
45. Gjykata supozon se parashtruesi i kërkesës konsideron se deri te shkelja e këtyre të drejtave ka ardhur si rezultat i shkeljeve të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së, të cilat parashtruesi i kërkesës i ka arsyetuar.
46. Marrë parasysh se në rastin konkret neni 31 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së nuk zbatohen tek propozimi për përsëritjen e procedurës, Gjykata nuk do të vlerësojë shkeljet e pretenduara të neneve 3 dhe 24 [Barazia para Ligjit], dhe 46 [Mbrojtja e Pronës] si dhe nenit 10 të Deklaratës Universale, për shkak se parashtruesi të njëjtat nuk i ka arsyetuar.
47. Për këto arsye, Gjykata më tej konsideron se kërkesa e parashtruesit nuk i ka plotësuar kriteret procedurale për pranueshmëri siç përcaktohet me Kushtetutë dhe siç parashihet më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës, andaj duhet të deklarohet e papranueshme.

Vlerësimi i kërkesës për masë të përkohshme

48. Gjykata vëren se parashtruesi në kërkesë kërkon që Gjykata të vendosë masë të përkohshme, duke pezulluar Aktvendimin e Gjykatës Supreme, [Rev. nr.

67/2019], të 20 marsit 2019, dhe Aktvendimin [CN. nr. 659/2015] e Gjykatës së Apelit të Kosovës, të 21 dhjetorit 2018, deri në vendosjen përfundimtare nga Gjykata.

49. Për të miratuar masën e përkohshme, në pajtim me rregullin 57 (5) të Rregullores së punës, Gjykata duhet të konstatojë që:

“(5) Nëse pala që kërkon masë të përkohshme nuk paraqet dëshmitë e nevojshme, Gjykata do të refuzojë kërkesën për masë të përkohshme”.

50. Siç është konkluduar më parë, kërkesa e parashtruesit të kërkesës lidhur me refuzimin nga gjykatat e rregullta për të përsëritur procedurën nuk është *ratione materiae* në pajtim me nenin 31 të Kushtetutës, prandaj edhe kërkesa e parashtruesit të kërkesës për masë të përkohshme duhet të refuzohet.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenin 20 të Ligjit dhe në pajtim me rregullat 39 (3) (b) dhe 57 (5) të Rregullores së punës, më 13 nëntor 2019, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. TA REFUZOJË kërkesën për masë të përkohshme;
- III. TUA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- IV. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Radomir Laban

Radomir Laban



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi

Arta Rama-Hajrizi